

DREJT CIKLEVE MË TË MIRA ZGJEDHORE: PROPOZIME PËR AVANCIM CILËSOR TË LEGJISLACIONIT ZGJEDHOR

Qytetarët e Maqedonisë së Veriut, në më pak se një vit e gjysmë, në tri raste, zgjedhën përfaqësuesit e tyre në Presidencë, në Kuvend dhe në pushtetin lokal. Ajo që për elektoratin përbënte një privilegj demokratik, për institucionet dhe pjesëmarrësit e pavarur në zgjedhje nënkuptonte sfida të reja dhe beteja ligjore. Për vëzhguesit ndërkombëtarë, nga ana tjetër, edhe këto zgjedhje ishin shkak për vërejtje dhe për dërgimin e një sinjali të qartë mbi nevojën për përmirësimin e legjislacionit zgjedhor.

Në dy dekadat e fundit, Kodi Zgjedhor është ndryshuar më shumë se tridhjetë herë. Ky problem u trajtua kohët e fundit nga ish-Kryetari i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, Boris Kondarko, i cili pak para zgjedhjeve lokale vuri **në dukje nevojën e miratimit të një Kodi zgjedhor krejtësisht të ri**, duke theksuar se ligji aktual ka paqartësi dhe pasaktësi që hapin çështje dhe sfida të shumta ligjore.

Edhe pse rekomandimet ndërkombëtare për reformat zgjedhore theksojnë se ato duhet të iniciohen **menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve** dhe të finalizohen të paktën **një vit para ciklit të ardhshëm zgjedhor**, praktika maqedonase tregon se ndryshimet më së shpeshti bëhen në mënyrë reaktive dhe drejtpërdrejt para zgjedhjeve.

Kjo mënyrë e ndërhyrjes në legjislacionin zgjedhor është problematike sepse lë hapësirë për boshllëqe të shumta ligjore, të cilat më vonë përbëjnë një sfidë për punën e institucioneve zgjedhore, por edhe për pjesëmarrjen e kandidatëve të pavarur **në proceset zgjedhore**. Miratimi i nxituar dhe jo-inkluziv i ndryshimeve ligjore e kufizon mundësinë e institucioneve që të përshtaten me kohë dhe të vënë në dukje mangësi ose mospërputhje të mundshme, çka krijon rrezik për gabime gjatë zbatimit të zgjedhjeve. Si rezultat, besimi i publikut dhe legjitimiteti i procesit zgjedhor minohen, ndërsa ndryshimet perceptohen si të pamatura dhe të diktura nga interesat aktuale politike.

Pas zgjedhjeve lokale, kryetari i Kuvendit Afrim Gashi **njoftoi krijimin e një grupi pune për Ligjin e ri** me përfaqësues nga të gjitha grupet parlamentare. **Partitë propozuan përfaqësuesit e tyre**, por mbetet ende e paqartë se kush, përveç deputetëve, do të marrë pjesë në atë grup pune. Për më tepër, është e paqartë nëse bëhet fjalë për vazhdimin e punës së **grupit të mëparshëm të punës në Ministrinë e Drejtësisë**, apo nëse procesi do të rezultojë në ndryshime në ligjin ekzistues apo në zhvillimin e një zgjidhjeje ligjore krejtësisht të re. Nëse edhe këtë herë aktorët politikë merren vesh mes vete, duke e injoruar nevojën për debat të gjerë dhe konsensus shoqëror, do të vazhdojmë t'i përsërisim të njëjtat gabime dhe të mbetemi të bllokuar në rrethin e problemeve të pazgjidhura, të cilat në mënyrë të pashmangshme do të shfaqen që në ciklin e ardhshëm zgjedhor.

Rezultati i zgjedhjeve të fundit lokale ilustron edhe një herë mungesën e besimit të qytetarëve në sistemin politik dhe në proceset zgjedhore, gjë që reflektohet në pjesëmarrjen rekord të ulët dhe në rritjen e numrit të fletëvotimeve të pavlefshme. Prandaj, për rikthimin e besimit të

qytetarëve dhe forcimin e rendit demokratik, ndryshimet në legjislacionin zgjedhor duhet të analizohen në mënyrë të thelluar, të diskutohen, të jenë konsensuale dhe të harmonizohen me praktikën ndërkombëtare dhe me rekomandimet e OSBE-së dhe ODIHR-së

Njoftimi për përgatitjen e një ligji të ri dhe zbatimin në kohë të reformave gjithëpërfshirëse zgjedhore është sigurisht i mirëpritur. Por ka disa aspekte që deputetët, pavarësisht nga prejardhja dhe interesat e partisë, duhet të marrin parasysh.

1. Pa një debat të gjerë, Kodi zgjedhor do të ketë përsëri mospërputhje të shumta

Përveç institucioneve përkatëse zgjedhore dhe mbikëqyrëse, në dialogun për ndryshimet zgjedhore duhet të përfshihen edhe ekspertë nga OSBE dhe ODIHR, media, organizatat e shoqërisë civile dhe natyrisht përfaqësues të lëvizjeve të pavarura civile, si më të prekurit nga ndryshimet e fundit të diskutueshme në Kodin zgjedhor.

2. Lëvizjet e pavarura dhe kandidatët duhet të jenë pjesë e lojës

Precedenti me pasigurinë rreth pjesëmarrjes së kandidatëve të pavarur në zgjedhjet e mëparshme është një rrezik që një shoqëri demokratike nuk guxon t'ia lejojë vetes. Prandaj, deputetët, së bashku me palët e tjera të interesuara, veçanërisht me lëvizjet e pavarura, duhet të gjejnë një zgjidhje konsensuale për numrin e firmave për kandidatura të pavarura, në përputhje me praktikën ndërkombëtare dhe në frymën e lehtësimit të qasjes në zgjedhje për kandidatët që nuk mbështeten nga një parti politike.

3. Qasje e pabarabartë në hapësirë dhe para për reklamim

Zgjedhjet lokale treguan edhe një herë se mekanizmi i shpërndarjes së hapësirës dhe mjeteve për reklamim nuk siguron garë të drejtë për të gjithë pjesëmarrësit. Partitë më të vogla me grupe parlamentare (ZNAM edhe Levica) nuk i janë bashkuar asnjë kategorie. Partitë me një ose dy deputetë morën 7% të hapësirës për reklamim dhe të financimit shtetëror, ndërsa partitë jashtëparlamentare dhe kandidatët e pavarur shpërndanë mes tyre vetëm 3%. OSBE-ja në të gjitha raportet e vëzhgimeve ka vërejtur se formula e vendosur në këtë mënyrë favorizon partitë më të mëdha dhe thekson nevojën për rishikimin e kriterëve të shpërndarjes, me qëllim sigurimin e kushteve të barabarta dhe të ndershme për të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje.

Kërkesat po bëhen gjithnjë e më të forta, përfshirë edhe **nga institucionet shtetërore**, për heqjen e plotë të reklamimit me mjete shtetërore, **për shkak të ekzistencës së rreziqeve për korrupsion** dhe ndikimit të ardhshëm të partive politike mbi politikën redaktuese të mediave. Nëse ruhet financimi zgjedhor, duhet të rishikohen dhe të rriten pjesët e mjeteve dhe hapësirës për reklamim për partitë e vogla dhe kandidatët e pavarur, të cilët aktualisht marrin vetëm 3% të shpërndarjes. Kandidatët dhe lëvizjet e pavarura, për shkak të mungesës së financimit të rregullt shtetëror, mund të mbështeten vetëm te donacionet për funksionimin e tyre dhe pjesëmarrjen në zgjedhje, gjë që rrit edhe më shumë pabarazinë në procesin zgjedhor.

4. Paratë shtetërore për reklamim në portalet e internetit pa kritere të qarta

Në zgjedhjet lokale është **miratuar reklamimi politik me pagesë për 246 portalet të internetit**, ndërsa vetëm 60 media online janë regjistruar në **Regjistrin e Mediave Online**. Është e nevojshme të vendosen kritere të qarta për kushtet që portalet duhet t'i përmbushin për të aplikuar për reklamimin politik të paguar në KSHZ, me qëllim parandalimin e keqpërdorimeve dhe largimit të fondeve shtetërore drejt "mediave fantazmë".

5. Internet portalet nuk kanë pasoja për mosdhënien e raporteve financiare

Edhe pse të gjitha mediat kanë detyrimin të raportojnë hapësirën e reklamave të blera dhe fondet e shpenzuara për reklamimin zgjedhor, portalet në internet janë të përjashtuara nga dispozitat ndëshkuese për mosrespektimin e këtij detyrimi, gjë që dëmton parimet e transparencës dhe përgjegjësisë. Prandaj, ligji i ri duhet të parashikojë dispozita ndëshkuese të barabarta për të gjithë promovuesit e pjesëmarrësve në zgjedhje.

6. Regjistrimi i shpenzimeve partiake në rrjetet sociale

Edhe pse ekziston si detyrim në formularin e raporteve financiare të fushatave zgjedhore, partitë politike rrallë i raportojnë shpenzimet në hapësirën online. Një pjesë e vogël e tyre regjistron shpenzimet për promovim në portalet online, por asnjë parti nuk raporton sa para shpenzon për reklamim në rrjetet sociale. Prandaj, është e nevojshme që Ministria e Financave, si institucioni që përcakton udhëzimin dhe formularin për raportimin financiar zgjedhor, si dhe KSHZ-ja dhe DZZH-ja, si organet kompetente për mbikëqyrjen e financimit zgjedhor, t'ua bëjnë të qartë të gjithë pjesëmarrësve në zgjedhje se ekziston detyrimi për të raportuar shpenzimet për reklamim në rrjetet sociale në raportet financiare, si dhe të vendosen sanksione të përshtatshme në rast se pjesëmarrësit refuzojnë t'i raportojnë këto shpenzime.

7. Ndryshimet e fundit kanë ulur transparencën financiare të fushatave

Ndryshimet në nenin 84 në vitin 2024 shfuqizuan detyrimin për të paraqitur raport financiar që specifikonte të ardhurat dhe shpenzimet në ditën e 11-të të fushatës zgjedhore dhe një ditë pas përfundimit të fushatës. Rregullat e reja parashikojnë vetëm raportimin e donacioneve të pranuar, gjë që, në ndryshim nga zgjidhja e mëparshme, e pamundëson kontrollin e vazhdueshëm dhe zbulimin e hershëm të keqpërdorimeve të mundshme. Prandaj, është i nevojshëm rikthimi i detyrimit të mëparshëm për raportim financiar të vazhdueshëm dhe të detajuar gjatë fushatës, me qëllim forcimin e transparencës së procesit zgjedhor.

8. Partitë nuk respektojnë afatet për dorëzimin e raporteve tek organet mbikëqyrëse

Edhe në këtë rrethanë të lehtësuar, ku ata raportojnë, disa nga pjesëmarrësit në zgjedhje rregullisht **nuk respektojnë afatet e parashikuara për dorëzimin e raporteve** për shpenzimet zgjedhore. Prandaj, i kujtojmë organet mbikëqyrëse se, sipas dispozitave ndëshkuese të parashikuara, neni 189 (gjobë prej 9,000 euro), mosrespektimi i afateve ligjore është i ndëshkueshëm dhe duhet të jetë në mënyrë të rreptë objekt i veprimit, gjë që si praktikë është zbatuar edhe në ciklet zgjedhore të mëparshme.

9. Dorëzimi elektronik i raporteve financiare

Me qëllim përshpejtimin e procedurës së raportimit dhe rritjen e efikasitetit të mbikëqyrjes nga institucionet dhe publiku, është e nevojshme të parashikohet detyrimi që raportet të dorëzohen në format digjital. Në fakt, kjo është edhe angazhimi i parashikuar (4.1.) për digjitalizimin e raportimit financiar të partive politike në **Planin e Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur (2024-2026)**.

Pranimi i përgjithshëm dhe konsistenca e rregullave zgjedhore, si dhe zbatimi me kohë i rekomandimeve për reforma, janë të rëndësishme thelbësore për procesin zgjedhor. Fatkeqësisht, tek ne, Kodi Zgjedhor si themel i rendit demokratik, pothuajse tradicionalisht pëson ndryshime kyçe në një proces të shpejtë, jo-transparent dhe jo-inkluziv – çka është një vërejtje e rregullt në të gjitha raportet zgjedhore të Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të OSBE-së dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare.

Për të forcuar besimin në procesin zgjedhor dhe për të siguruar pjesëmarrje të barabartë të të gjithë aktorëve, ndryshimet e ardhshme ose miratimi i një Kodi zgjedhor të ri duhet të jenë objekt i një debati të gjerë dhe gjithëpërfshirës, në të cilin do të marrin pjesë të gjitha palët e interesuara, përfshirë të gjitha partitë politike, kandidatët e pavarur, organizatat qytetare dhe, natyrisht, ekspertët ndërkombëtarë nga OSBE-ja dhe ODIHR-i, të cilëve rekomandimet e tyre janë gjithashtu tema kryesore para çdo cikli zgjedhor. Vetëm në këtë mënyrë institucionet do të rikthejnë besimin e qytetarëve në proceset zgjedhore, kandidatët zgjedhorë do të pajisen me kushte të barabarta, ndërsa institucionet do të pajisen me mjete efektive për mbikëqyrje të lehtë dhe përmbledhje të flukseve zgjedhore.

Ky dokument për politika publike është pjesë e projektit "**Nxitja e debatit mbi llogaridhënien dhe anti-korrupsionin**", i cili synon të kontribuojë në proceset e reformave në Maqedoninë e Veriut duke forcuar rolin e Kuvendit në luftën kundër korrupsionit dhe krijimin e reformave në sundimin e ligjit, duke mundësuar dialogun midis partive dhe të rinjve, si dhe midis deputetëve dhe shoqërisë civile. Projekti është mbështetur nga Fondi Kombëtar për Demokraci.